



KA NISUR FAZA PËRFUNDIMTARE E GJYKIMIT NDAJ LIDERËVE TË UÇK-së NË HAGË

KËRKESA E PROKURORISË SË HAGËS PËR DËNIMIN E LIDERËVE TË UÇK-së, SKANDALOZE DHE POLITIKE

FAQE 4-5



Në Gjykatën Speciale ka nisur faza përfundimtare e gjyqimit të liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Prokurorët e Speciales në deklaratat e tyre përfundimtare kanë kërkuar nga 45 vjet burgim

për katërshen e UÇK-së. Kjo kërkesë ka ngjallur reagime të shumta në Kosovë. Njohës të çështjeve juridike dhe përfaqësues të partive politike e kanë vlerësuar si skandaloze dhe politike kërkesën e prokurorisë për dën-

imin e liderëve të UÇK-së. Ndërsa presidentja Vjosa Osmani ka thënë se çdo përpjekje që tenton ta barazojë luftën e UÇK-së me krimet e agresorit gjenocidal serb e minon besimin në drejtësi dhe e dëmton rëndë paqen afatgjatë

OSMANI: RRUGA E KOSOVËS DREJT NATO-s DHE BE-SË ËSHTË E PANDALSHME, MARRËDHËNIET ME SHBA-në PO THELLOHEN F. 8



UÇK-ja SËRISH DO TË TRIUMFOJË! F. 3

Shkruan:
Arianit BYTYÇI



ALARM NË SHBA, FRUTHI 'SHPËRTHEN' NË DISA SHTETE F. 2

BE-ja: ME ARRESTIMIN E SHTETASVE TË KOSOVËS, SERBIA PO SHKEL MARRËVESHJEN E VITIT 2015 F. 2

KOMANDANTI I FSK-SË DEKORON EKIPIN E KËRKIM-SHPËTIMIT NË SHQIPËRI F. 7

EKONOMI



RRITET INDEKSI I PËRGJITHSHËM I INPUTEVE NË BUJQËSI F. 8

RRITJE E NUMRIT TË VIZITORËVE NË HOTELE NË DHJETOR TË 2025-S KRAHASUAR ME VITIN PARAPRAK F. 8

SPORT



NIS STINORI PRANVEROR NË SUPERLIGËN E KOSOVËS NË FUTBOLL, FITOJNË FAVORITËT F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BE-ja: ME ARRESTIMIN E SHTETASVE TË KOSOVËS, SERBIA PO SHKEL MARRËVESHJEN E VITIT 2015

PRISHTINË, 9 SHKURT - Bashkimi Evropian tha se arrestimi i fundit nga Serbia i një veterani të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është “një shkelje tjetër” e obligimeve të Serbisë të Marrëveshjes për dialogun dhe drejtësinë të vitit 2015. “Sipas kësaj marrëveshjeje, Serbia është zotuar që të mos iniciojë hetime penale apo ndjeje penale për krimet që pretendohet se janë kryer në Kosovë, përveç nëse një gjë e tillë kërkohet nga autoritetet e Kosovës. Juridiksioni mbi pretendimet për krime të luftës dhe vepra të tjera serioze bie mbi institucionet e Kosovës. I bëjmë thirrje Serbisë që të respektojë zotimet e saj”, tha një zëdhënës i Komisionit

Evropian për “Radion Evropa e Lirë”. Më 5 shkurt autoritetet e Serbisë arrestuan Mitehat Llozhanin me të hyrë në terrorin serb nga kufiri me Kroacinë. Ai, sipas autoriteteve, në Beograd dyshohet për krime kundër popullatës civile. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka kërkuar angazhim të bashkësisë ndërkombëtare lidhur me këtë rast. Sipas Serbisë, i arrestuari dyshohet se ka kryer trajnime si pjesëtar i UÇK-së i Zonës Operative të Dukagjinit më 1998 dhe 1999 "pas së cilave ka marrë pjesë në sulme terroriste kundër anëtarëve të MPB-së serbe dhe ushtrisë jugosllave". Në njoftim thuhet po ashtu se



"si anëtar i grupit të komanduar nga Ramush Haradinaj, ai ka marrë pjesë në rrëmbim dhe masakrim të policëve". Por, nga Organizata e

Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i kanë thënë “Radios Evropa e Lirë” se i arrestuari ka marrë pjesë në disa stërvitje në Shqipëri, por nuk ka informacione të ketë

qenë në vijat e frontit në Kosovë. Nënkryetari i kësaj organizate të veteranëve, Gazmend Sylaj, ka thënë për “Radion Evropa e Lirë” se Llozhanin iu gjet kartela e veteranit në xhep gjatë kontrollit nga autoritetet serbe. Serbia ka arrestuar vazhdimisht shtetas të Kosovës nën pretendime për krime lufte në Kosovë më 1998-’99, dhe vetëm në vitin 2025 u regjistruan disa arrestime të tilla. Serbia gjatë viteve ’90 e karakterizoi UÇK-në si organizatë terroriste, ndërsa për Kosovën, UÇK-ja është organizata që mbrojti popullsinë lokale nga represioni i forcave të armatosura jugosllave.

ALARM NË SHBA, FRUTHI ‘SHPËRTHEN’ NË DISA SHTETE

WASHINGTON, 9 SHKURT - Shpërthimi i fruthit në disa shtete të Amerikës ka vënë në alarm autoritetet atje. Një zyrtar i lartë i shëndetësisë i bëri thirrje publikisht qytetarëve që të vaksinohen kundër sëmundjes. “Ju lutem, vaksinohuni”, deklaroi Dr. Mehmet Oz, administrator i Qendrave për Shërbimet Medicare dhe Medicaid. “Sot kemi një zgjidhje të qartë për këtë problem”, shtoi ai. Oz, i njohur si kirurg kardiale, mbrojti rekomandimet federale të rishikuara së fundmi për vaksinat, duke përfshirë edhe



komentet e mëparshme të presidentit Donald Trump dhe sekretarit të shëndetësisë Robert F. Kennedy Jr., lidhur

me efikasitetin e vaksinave. Mesazhi i Oz ishte i qartë për fruthin. “Jo të gjitha sëmundjet janë po aq të rrezikshme dhe

jo të gjithë njerëzit janë po aq të ndjeshëm ndaj tyre”, tha ai në emisionin “State of the Union” në CNN. “Por fruthi është një sëmundje kundër së cilës duhet patjetër të vaksinoheni”, shtoi ai. Me qindra raste të konfirmuara tashmë, fruthi në Karolinën e Jugut, ka tejkaluar numrin rekord të regjistrimeve gjatë shpërthimit të vitit 2025 në Teksas. Raste të shumta janë shënuar edhe në zonën kufitare mes Utah dhe Arizonës, ndërsa shumë shtete të tjera kanë regjistruar infeksione gjatë këtij viti.

Shpërthimet kanë prekur kryesisht fëmijët dhe kanë ndodhur në kohën kur ekspertët e sëmundjeve infektive paralajmërojnë se rritja e mosbesimit ndaj vaksinave mund të kontribuojë në përhapjen e sëmundjeve që dikur konsideroheshin të zhdukura nga zyrtarët e shëndetit publik. Sipas të dhënave federale, normat e vaksinimit në ShBA kanë rënë, ndërsa rastet e sëmundjeve të parandalueshme me vakcina, si fruthi dhe kolla e mirë, po rriten në të gjithë vendin.

‘BITCOIN’-I NË RËNIE, FRIKË E MADHE MES INVESTITORËVE TË KRIPTOMONEDHAVE

NJU-JORK, 9 SHKURT - Rënia e ndjeshme e “Bitcoin”-it ka ngjallur frikë tek investitorët e kriptomonedhave. Që nga fillimi i vitit çmimi i “Bitcoin”-it ka rënë 28 % dhe shqetësimi se mund të bjerë nën nivelin 63.295 dollarë po trondit tregjet globale, ku është shtuar ndjeshëm presioni i shitjeve. Duket se pasiguria politike lidhur me politikën monetare të Shteteve të Bashkuara ka kontribuar në nervozizmin e investitorëve dhe në rritjen e

luhatjeve në tregje. Ekspertët thonë se dobësimi i aksioneve të teknologjisë dhe paqëndrueshmëria në tregjet e floririt dhe metaleve të tjera po ndikojnë negativisht edhe në kriptomonedha. Ata paralajmërojnë se paqëndrueshmëria pritët të zgjasë edhe në periudhën në vijim. Kjo pikiatë e çmimit në nivelin më të ulët të 16 muajve të fundit vjen pavarësisht mbështetjes personale dhe publike të presidentit amerikan Donald Trump për



kriptomonedhat si dhe faktit që jo më larg se në tetorin e 2025-s “Bitcoin” kishte mbërritur një rekord historik prej 122.200

dollarësh. Investitorët ishin inkurajuar nga angazhimi i Trumpit në sektor dhe mbështetja e tij e

hapur për kriptomonedhat, si edhe nga premtimet për lehtësimin e legjislacionit. “Bitcoin” është kriptomonedha më e madhe dhe më e njohur në botë, një formë e parasë digjitale që nuk kontrollohet nga një institucion financiar qendror. Një nga veprimet e para të Trumpit pas rikthimit në Shtëpinë e Bardhë në janar 2025 ishte një urdhër ekzekutiv për ta bërë ShBA-në “kryeqytetin botëror të kriptomonedhave”.

Shemben dy ndërtesa në Liban, 15 viktima

TRIPOLI, 9 SHKURT - Numri i të vdekurve nga shembja e dy ndërtesave në Tripoli të Libanit ka shkuar në 15, pasi operacionet e kërkim-shpëtimit kanë përfunduar, tha sot kreu i

shërbimit të mbrojtjes civile, sipas Agjencisë Kombëtare të Lajmeve Libaneze. Imad Khrais theksoi se ekipet e shpëtimit nxorën tetë persona nën rrënojat e ndërtesave në lagjen

Bab al-Tabaneh të qytetit verior libanez. Abdel Hamid Karime, kreu i këshillit bashkiak të Tripolit, duke folur në një konferencë për shtyp në Tripoli, nuk tha se

sa njerëz mund të jenë të bllokuar ende nën rrënoja. Më parë, kreu i agjencisë së mbrojtjes civile kishte thënë se ndërtesat që u shembën kishin brenda 22 banorë.



USHTRIA E KOSOVËS NË PROVËN FINALE

Ushtria e Kosovës është në fazën finale të transformimit, me synim përmbylljen e kapaciteteve të plota deri në vitin 2028. Pavarësisht prej përparimit në armatim, trajnim dhe buxhet, ekspertët paralajmërojnë se nevojiten investime shtesë në personel, në mirëqenie dhe në komponentin rezervë. Serbia mbetet kërcënimi kryesor për sigurinë e Kosovës, ndërsa NATO-ja vazhdon të luajë rol kyç në ndërtimin e kapaciteteve dhe ruajtjen e stabilitetit

PRISHTINË, 9 SHKURT - Pushtetet janë ndërruar, ashtu edhe komandantët, por ideja e ushtrisë ka mbetur. Në një skenë politike shpesh të përçarë, ndërtimi i Ushtrisë së Kosovës është një nga proceset e rralla që ka vazhduar pa u ndalur. Ky konsensus institucional ka siguruar vazhdimësi në tranzicion, investime të qëndrueshme dhe përafrim të pandërprerë me standardet e NATO-s. Sipas gjeneralit në pension Naim Haziri, i cili ka ndjekur nga afër disa faza të zhvillimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, kjo forcë operon sot sipas doktrinave moderne të luftës, ka kapacitete funksionale për rreziqet aktuale dhe pritet të përmbyllë tranzicionin në ushtri deri në vitin 2028 - në përputhje me afatet e planit fillestar. “Jam shumë optimist, edhe pse kjo është faza më e rëndësishme e ngritjes së Forcës. Aktualisht po zhvillohen kapacitetet ajrore dhe po forcohen regjimentet luftarake, me elemente mbështetëse të operacioneve. Jam i bindur se FSK-ja do t’i arrijë kapacitetet e plota operacionale në kohën e parashikuar dhe do të jetë një forcë kredibile, e ndërveprueshme me të gjitha ushtritë e NATO-s”, thotë Haziri për programin “Expose” të “Radios Evropa e Lirë”. Ky rrugëtim nisi në vitin 2018, kur Kuvendi i Kosovës miratoi ligjet që hapën procesin dhjetëvjeçar të transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në një ushtri me kapacitete të plota. Në atë kohë, NATO-ja - e pranishme në Kosovë me mision paqeruajtës që nga paslufta - e cilësoi këtë vendim si “të papërshtatshëm në kohë”, për shkak të marrëdhënieve të tensionuara në mes të Kosovës dhe Serbisë. Por, ndryshe prej saj, Shtetet e Bashkuara e mbështetën këtë hap, duke e cilësuar tranzicionin e FSK-së si “historik” dhe duke konfirmuar angazhimin e tyre për të mbështetur zhvillimin e saj profesional. Hashim Thaçi, atëkohë president i Kosovës dhe komandant suprem i FSK-së, tha se krijimi i ushtrisë së

Kosovës është rezultat i një shekulli sakrificash. “I siguroj të gjitha komunitetet në Kosovë, e veçanërisht komunitetin serb, se FSK-ja do të vazhdojë t’u shërbejë të gjithë qytetarëve, pa dallime etnike”, tha Thaçi në dhjetor të vitit 2018. Diskursi institucional - FSK-ja si forcë në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës - u ruajt i pandryshuar edhe nën presidencën e Vjosa Osmanit. “Djemtë dhe vajzat e Forcës sonë janë të gatshëm për ta mbrojtur integritetin territorial dhe sovranitetin e shtetit tonë - Republikës së Kosovës - në çdo pëllëmbë të tij”, tha Osmani në dhjetor të vitit 2022. FSK-ja edhe sot duhet të marrë leje nga misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR, për të operuar në pjesën veriore të vendit, ku popullata shumicë është serbe. Ky kufizim operacional u vendos nga ish-presidenti Hashim Thaçi në vitin 2013, përmes një letre të dërguar shefit të atëhershëm të NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, dhe mbetet në fuqi. “Radio Evropa e Lirë” pyeti Presidencën e Kosovës nëse po shqyrton rishikimin e obligimit për leje nga KFOR-i për operimet e FSK-së në veri në prag të përmbylljes së transformimit të saj në ushtri, por deri tani nuk mori përgjigje. I kontaktuar nga REL-i, një zëdhënës i NATO-s tha vetëm se “që nga viti 2016, Ekipi Këshillues dhe Ndërlidhës i NATO-s - i cili është i ndarë nga KFOR-i - ka ofruar mbështetje të konsiderueshme për zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, në kuadër të mandatit të saj fillestar të mbrojtjes civile, përmes ndërtimit të kapaciteteve, edukimit dhe koordinimit të trajnimeve”. Ndër vite, Forca e Sigurisë së Kosovës ka marrë pjesë në një sërë misionesh dhe aktiviteteve rajonale e ndërkombëtare, kryesisht në kuadër të operacioneve humanitare, trajnuese dhe paqeruajtëse. Së fundmi, kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, bëri me dije se FSK-ja do të marrë pjesë edhe në Forcën Ndërkombëtare Stabilizuese



për Gazën. Aktualisht, sipas Ministrisë së Mbrojtjes, në proces është shqyrtimi i formës dhe kapacitetit, me të cilin do të mund të kontribuohet në këtë forcë paqeruajtëse. Zëvendësministri në detyrë i Mbrojtjes, Shemsi Syla, konfirmon se FSK-ja ka përmbyllur tashmë objektivin për 5 000 trupa të rregullta, ndërsa mbetet ende për t’u plotësuar komponenti rezervë prej 3 000 pjesëtarësh. Megjithëse përbërja e plotë e armatimit të FSK-së nuk është bërë publike, pajisjet e konfirmuara zyrtarisht variojnë nga automjetet e blinduara deri te dronët. Sipas Sylës, kapacitetet janë ndërtuar në bashkëpunim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë dhe armatimi e pajisjet janë në përputhje me standardet e NATO-s. “Aleatët nga të cilët kemi blerë armatim, përfshijnë: Shtetet e Bashkuara, Turqinë, Kroacinë, Britaninë e Madhe, Gjermaninë, Italinë e të tjera. Sot, në këtë stad të ngritjes, por edhe nesër kur t’i kemi kapacitetet e plota, ne do të jemi të gatshëm të ofrojmë siguri”, thotë Syla për Exposed. Buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes ka shënuar rritje të ndjeshme vitet e fundit, duke u trefishuar nga 67.3 milionë euro në vitin 2021 në 207.8 milionë euro vitin e kaluar. Strategjia e Sigurisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2022-2027 e identifikon qartë Serbinë dhe pretendimet e saj territoriale si kërcënimin kryesor për sigurinë kombëtare. Që nga fillimi i krijimi i ushtrisë së Kosovës ka hasur në kundërshtime të forta nga Serbia - vendi që, gjatë pesë vjetëve të fundit, ka shpenzuar më së shumti për ushtrinë në gjithë Ballkanin Perëndimor. Presidenti serb, Aleksandar

Vuçiq, ka akuzuar Prishtinën se “po u bie daulleve të luftës” dhe po rrezikon komunitetin serb. Ky diskurs ka ushqyer rezistencë të vazhdueshme në mesin e komunitetit serb ndaj vendimeve të Qeverisë së Kosovës, veprimeve të forcave të sigurisë dhe shtrirjes së autoritetit shtetëror, sidomos në veri. Kulmi i kësaj përplasjeje ka qenë sulmi i armatosur ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë në vitin 2023. Sipas gjeneralit në pension, Naim Haziri, Serbia mbetet kërcënimi kryesor si ushtarak, ashtu edhe joushtarak, për Kosovën. Ai përmend në mënyrë të veçantë edhe kërcënimet hibride, përfshirë sulmet kibernetike, por thekson se FSK-ja, edhe tash, ka kapacitete të mjaftueshme për t’iu përgjigjur çdo kërcënimi. “Kur një ushtri mbrohet dhe një ushtri sulmon, atëherë proporcioni i forcave është varësisht inxhinierisë që përgatitet, tre me një, pesë me një, tetë me një... Dhe FSK-ja, me kapacitetet që sot i ka, është e gatshme që në çdo kohë ta mbrojë integritetin territorial të Republikës së Kosovës”, thotë Haziri. Megjithatë, ai thekson nevojën për investime më të mëdha në personelin e FSK-së, duke nënvizuar se mirëqenia e tij është faktor kyç për efektivitetin dhe gatishmërinë e forcës. “Mendoj se ka hapësirë të bëhet më shumë për personelin. Në fazën e dytë, investimet kanë qenë të fokusuara në blerje të armatimit, por nuk duhet përjashtuar as investimi në personel, në mënyrë që pjesëtarët të jenë më të motivuar për përgjegjësitë që i ushtrojnë”, thotë ai. Pagat në FSK ndryshojnë sipas gradave - me më të ulëtat për rekrutët e rinj dhe më të lartat për nënkolonelët dhe

gjeneralët. Ligji e lejon largimin vullnetar të pjesëtarëve, dhe të dhënat e Ministrisë së Mbrojtjes tregojnë se braktisjet ndodhin çdo vit - me një rritje të ndjeshme midis viteve 2021, kur u larguan 50 ushtarë, dhe 2023, kur numri i tyre arriti në 134. Zëvendësministri në detyrë, Shemsi Syla, thekson rëndësinë e vazhdimit të mbështetjes nga partnerët ndërkombëtarë për të siguruar trajnimin dhe pajisjet për ushtarët. Ai shton se FSK-ja ka arritur t’i integrojë të gjitha komunitetet në radhët e veta, ndonëse sfiduese mbetet pjesëmarrja e komunitetit serb. “Problemin më të madh na e kanë shkaktuar serbët. Me kërcënime e me shantazhe, kanë arritur t’i largojnë disa pjesëtarë. Në konkursat që kemi shpallur ka pasur vazhdimisht të interesuar, por vazhdojnë të kenë frikë”, thotë Syla. Falë bashkëpunimeve me partnerët ndërkombëtarë dhe standardeve të NATO-s, Syla thotë se FSK-ja është qysh tash e përgatitur të bashkohet me Aleancën - një synim i shprehur që nga fillimi i transformimit. Të njëjtin qëndrim e mbështet edhe gjenerali në pension, Naim Haziri. “Kosova është shumë më e fuqishme saqë mendohet dhe shihet nga dikush - në të gjitha aspektet”, sipas tij. E nga NATO-ja konfirmojnë për “Radios Evropa e Lirë” se aleanca “ofron kontribute të rëndësishme ushtarake për Kosovën”, por se “rruga drejt paqes së qëndrueshme është politike”. Ndaj, “NATO-ja vazhdon ta mbështesë fuqishëm dialogun e lehtësuar nga BE-ja” për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë... edhe pse ky proces mbetet i bllokuar prej kohësh, pa përparime që do ta nxirrnin nga vendnumërimi disavejeçar.



KA NISUR FAZA PËRFUNDIMTARE E GJYKIMIT NDAJ LIDERËVE TË UÇK-SË NË HAGË

KËRKESA E PROKURORISË SË HAGËS PËR DËNIMIN E LIDERËVE TË UÇK-së, SKANDALOZE DHE POLITIKE

Në Gjykatën Speciale ka nisur faza përfundimtare e gjykimit të liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Prokurorët e Speciales në deklaratat e tyre përfundimtare kanë kërkuar nga 45 vjet burgim për katërshen e UÇK-së. Kjo kërkesë ka ngjallur reagime të shumta në Kosovë. Njohës të çështjeve juridike dhe përfaqësues të partive politike e kanë vlerësuar si skandaloze dhe politike kërkesën e prokurorisë për dënimin e liderëve të UÇK-së. Ndërsa presidentja Vjosa Osmani ka thënë se çdo përpjekje që tenton ta barazojë luftën e UÇK-së me krimet e agresorit gjenocidal serb e minon besimin në drejtësi dhe e dëmton rëndë paqen afatgjatë

EPOKA
ERE

Lirim GECI

HAGË, 9 SHKURT - Procesi gjyqësor në Gjykatën Speciale ndaj liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, është duke shkuar drejt përfundimit. Të hënën ka nisur paraqitja e deklarave përfundimtare në këtë proces maratonik gjyqësor. Të parët që kanë nisur me paraqitjen e fjalëve përfundimtare në këtë proces gjyqësor kanë qenë prokurorët e Gjykatës Speciale. Prokurorja e specializuar e Speciales, Kimberly West, ka kërkuar të merret vendim për

dënim me burgim ndaj secilit prej të akuzuarve. "Të akuzuarit kanë kryer krime ndaj kundërshtarëve të tyre të perceptuar për të pasur kontroll në gjithë Kosovën... Dëshmitë e të gjithë dëshmitarëve si dhe të gjitha provat tregojnë se të gjitha këto krime janë kryer dhe se të akuzuarit mbajnë përgjegjësi ligjore për to", ka thënë West, duke kërkuar nga trupi gjyqësor t'i dënojë me nga 45 vjet burgim Thaçin, Veselin, Selimin dhe Krasniqin. "Ne i qëndrojmë faktit që ne kërkojmë dënimin e personave konkret. Nuk kërkojmë një dënim për shtabin e përgjithshëm, po për persona konkretë. Zyra e Prokurorisë

Speciale (ZPS) kërkon vendim dënim për të gjitha pikat e aktakuzës dhe vendosjen e një vendimi të vetëm prej 45 viteve, mbështetur në kontributet individuale të krimeve të bëra ose të kryera nga secili prej personave - Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi. Këto krime janë krime lufte dhe krime kundër njerëzimit dhe janë të rënda në natyrë", ka thënë prokurorja West. Prokurorja West ka thënë se faktet e kësaj çështjeje dhe jurisprudenca e vazhdueshme mbështesin një afat të gjatë për burgimin e secilit të akuzuarve. Më tutje, West ka përmendur disa

dëshmitarë që kishin dëshmuar në këtë proces gjyqësor. Ajo ka thënë ky gjykim nuk i ka shpëtuar as klimës së frikësimit të dëshmitarëve që ka qenë insistuese dhe që ishte parashikuar prej prokurorisë nga fillimi. West ka thënë se ka pasur përpjekje edhe për ta shtrembëruar gjetjen e fakteve nga Gjykata Speciale. Në deklaratën përmbyllëse në gjyqin e madh ndaj ish-presidentit Hashim Thaçi dhe të tjerëve, prokurori i lartë i ZPS-së, Alan Tieger, ka theksuar angazhimin e të akuzuarve për të realizuar një qëllim të përbashkët gjatë vitit 1998. Ai ka vënë në dukje se ky qëllim ka qenë i qartë

dhe, siç ka thënë, është përsëritur vazhdimisht gjatë këtij periudhe kohore. "Qëllimi i përbashkët dhe angazhimi i të akuzuarve lidhur me këtë qëllim të përbashkët është bërë i qartë herë pas here gjatë gjithë 1998-s", është shprehur ai. Ndërkaq, në fillim të kësaj deklarate, Tieger ka paraqitur para trupit gjyqësor dëshmitë ndaj ish-kryerëve të UÇK-së të cilat pretendojnë se ata janë fajtorë për krime të kryera gjatë luftës. Sipas tij, në fund të vitit 1998 UÇK-ja kishte krijuar Gjykatën Ushtarake, e cila nuk ishte efektive pasi, siç ka argumentuar ai, në punën e saj ndërhyenin anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm, përfshirë Rexhep





Selimin dhe Jakup Krasniqin. Gjykata, ka thënë ai, ka shërbyer si “instrument nga ndërmarrja e përbashkët kriminale” kundër kundërshtarëve. Ai ka përmendur rastin e ndalimit të Blerim Kuçit, rasti i të cilit ishte iniciuar pranë kësaj gjykate dhe ndaj tij ishte shqiptuar dënues me vdekje. “Fate të njëjta ishin planifikuar për kundërshtarë të tjerë, që pretendoheshin të silleshin në pseudo-gjykatën për tradhti”, ka thënë prokuroria. Ndërsa Clare Lawson ka theksuar se kur bëhet fjalë për shenjestrimin e oponentëve dhe krimet që kanë pasuar, anëtarët e së ashtuquajturës “Ndërmarrje e përbashkët kriminale” po përpiqeshin t’i fshihnin veprimet e tyre dhe, siç është shprehur ajo, të kalonin pa u vënë re nga askush. Sipas prokurores, kjo është e dokumentuar dhe mbështetur nga shumë prova të paraqitura gjatë procesit. Në vazhdim të kësaj deklarate, Lawson ka përmendur një takim të Hashim Thaçit dhe Fatmir Limajt me përfaqësues të “Human Rights Watch”, duke pretenduar se Thaçi ka folur për arrestimin e dy personave. Prokurorja ka pretenduar se pas këshillës për lirimin e dy të ndaluarve, Thaçi, siç ka thënë ajo, është shprehur se s’duhet ndërhyrë në proces. “Kur u këshillua që të ndaluarit duhet të liroheshin dhe kur u tha që masat duhet të merreshin, ‘Human Rights Watch’ nuk mund të ndërhynte në procesin gjyqësor, domethënë kjo është çfarë tha Thaçi dhe nuk ishte e mundur që autoritetet civile, gjyqësore, të mund të ndikoheshin prej tyre”, ka thënë Lawson.

Prokuroria edhe sot (e martë) do t’i paraqesë deklaratat përmbyllëse ku do të pasohet edhe me deklaratat e mbrojtësit të viktimave. Për nesër (e mërkurë) është rezervuar për deklaratat përmbyllëse të mbrojtjes së Thaçit dhe asaj të Veselit, ku kjo e fundit do të vazhdojë edhe të enjten për të pasuar më pas me Krasniqin. Mbrojtja e Krasniqit do ta përfundojë deklaratën e saj përmbyllëse të premtën dhe pastaj do të vazhdojë ajo e Selimit.

Aktakuza kinse për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit ndaj katërshes së UÇK-së është konfirmuar më 26 tetor të vitit 2020.

Më 9 nëntor të vitit 2020, në paraqitjet e tyre të para, Jakup Krasniqi dhe Hashim Thaçi janë deklaruar të pafajshëm për akuzat që u vihen në barrë. Njëjtë është deklaruar edhe Veseli në paraqitjen e tij më 10 nëntor, sikurse edhe Rexhep Selimi më 11 nëntor.

Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi ndodhën në paraburgim që nga nëntori i vitit 2020, ndërsa procesi gjyqësor ndaj tyre ka nisur në prill të vitit 2023.

REAGIMET NDAJ KËRKESËS SË PROKURORISË SPECIALE

Kërkesa për dënimin e liderëve të UÇK-së, skandaloze dhe politike

Kërkesa e ZPS-së për dënimin me nga 45 vjet burgim për liderët e UÇK-së ka ngjatur reagime të shumta në Kosovë. Kryetari i veteranëve të UÇK-së, Hysni Gucati, e ka quajtur skandaloze kërkesën e kryeprokuores Kimberly West, për dënimin e çlirimtarëve në Hagë. Ai ka thënë se me këtë kërkesë, West ka kënaqur të gjithë ata që ishin kundër Kosovës dhe çlirimit të vendit.

Ndërsa njohësi i çështjeve politike, Ilir Deda, ka thënë se kërkesa e ZPS-së është në kundërshtim edhe me praktikën ndërkombëtare të drejtësisë. “Kërkesa e prokurorisë speciale është skandaloze sepse, ndër të tjera, kërkon ndëshkim kolektiv e jo individual siç është praktika ndërkombëtare deri sot, përfshirë Tribunalin e Hagës për krimet në ish-Jugosllavi. Kjo përbën precedent të paparë deri sot e që rezulton të jetë më shumë kërkesë e politikës sesa e drejtësisë sepse kërkesa për ndëshkim kolektiv është kërkesë për ndëshkim të krejt Kosovës. Pse nuk i thërret presidentja të gjithë liderët partiakë që të formulohet pozicioni i shtetit dhe të ndërmerren të gjithë hapat pasues? Kosova duhet menjëherë të fillojë të ndërtojë pozicion të unifikuar politik dhe juridik”, ka shkruar Deda në “Facebook”.

Kurse drejtori ekzekutiv i KDI-së, Ismet Kryeziu, ka thënë se edhe në gjykatat më të larta ndërkombëtare, përfshirë Gjykatën e Hagës, nuk ekziston praktikë e dënimeve kolektive. Sipas tij, madje dhe në rastet më të rënda, si gjenocidi në Srebrenicë, çdo kërkesë për dënim dhe çdo i akuzuar është vlerësuar individualisht, bazuar në rolet, vendimet dhe veprimet e secilit. “Kërkesa e Prokurorisë në Gjykatën Speciale, që katër të akuzuarit të dënohen ‘në bllok’ me nga 45 vjet burgim, është skandaloze për standardet e drejtësisë. Kjo më shumë është kërkesë politike për dënim kolektiv sesa një kërkesë juridike për drejtësi”, ka shkruar Kryeziu në “Facebook”.

Në anën tjetër, drejtori i KIPRED-it, Luzim Peci, ka thënë se kërkesës së ZPS-së për dënimin e liderëve të UÇK-së “po i vjen era shumë më tepër si përpjekje për dënim kolektiv sesa individual”. “Në esencë, në bazë të mendimit tim, kjo kërkesë shpërfaqë përgatitje tejet të dobët të rastit gjyqësor nga kjo prokurori”, ka thënë Peci.

Osmani: Çdo përpjekje për barazimin e luftës çlirimtare të UÇK-së me krimet e Serbisë minon besimin në drejtësi

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka reaguar pas deklaratave përfundimtare të prokurorëve të Gjykatës Speciale, ku është kërkuar dënimi i liderëve të UÇK-së. Ajo ka thënë se çdo përpjekje që tenton ta barazojë luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës “me krimet e agresorit gjenocidal serb e minon besimin në drejtësi dhe e dëmton rëndë paqen afatgjatë”. “Pavarësia e Kosovës ishte vullnet i popullit të Kosovës. Ishte sakrificë shekullore për të cilën dhanë jetën mijëra dëshmorë e civilë të pafajshëm e për të cilën luftuan, me heroizëm dhe me luftë të pastër, Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Gjenocidi, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës janë krime që Serbia i kreu kundër popullit të Kosovës ndër shekuj”, ka shkruar Osmani në “Facebook”.

Ajo ka thënë se gjatë luftës së fundit në Kosovë, Serbia kishte për qëllim shfarosjen e popullit shqiptar, qëllim të cilin e shpërfaqti nëpërmjet vrasjes dhe masakrimit të mijërave fëmijëve, grave, burrave e të moshuarve, dhunimeve të mijëra grave e burrave, shkatërrimit të qindra mijëra shtëpive, dëbimit të mbi 80 për qind të qytetarëve të Kosovës nga shtëpitë e tyre, spastrimit etnik, zhdukjes me dhunë të mijëra personave dhe krimeve të tjera të llahtarshme. “Çdo përpjekje që tenton të barazojë luftën çlirimtare të UÇK-së me krimet e agresorit gjenocidal serb e minon besimin në drejtësi dhe e dëmton rëndë paqen afatgjatë. Kosova dhe qytetarët e saj kërkojnë drejtësi. Lufta e UÇK-së ishte e drejtë dhe e pastër. Kjo e vërtetë nuk ndryshohet me tënim për ta rishkruar historinë dhe për ta njollësuar dhe zhvleftësuar betejën e popullit të Kosovës për liri”, ka shkruar Osmani.

LV-ja: Kërkesa e prokurorisë për dënimin e krerëve të UÇK-së, ndërhyrje politike në regjistrin e kujtesës dhe të historisë

Lëvizja Vetëvendosje ka deklaruar se kërkesa e prokurorisë për dënim maksimal ndaj krerëve të UÇK-së nuk është një akt për kërkim drejtësie, por një politikë që synon ta përmbysë rendin e së vërtetës. Kjo lëvizje ka theksuar se Jugosllavia e Serbisë së Slllobodan Millosheviqit ka kryer gjenocid në Kosovë. “Kërkesa e Prokurorisë Speciale për dënime prej 45 vjetësh për secilin nga ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nuk është një kërkesë neutrale drejtësie, por një ndërhyrje politike në regjistrin e kujtesës dhe të historisë. Këtu nuk po gjykohen individë të shpëputur nga konteksti, por po tentohet të gjykohe vetë akti i çlirimit. Ky është një proces që e zhvendos vëmendjen nga agresori te viktima dhe e paraqet rezistencën ndaj okupimit si krim, ndërsa okupimin si sfond të heshtur”, është thënë në reagimin e Vetëvendosjes.

Më tutje, Vetëvendosja ka theksuar se pretendimi se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka qenë ndërmarrje kriminale është jo vetëm i pavërtetë, por edhe një tentativë për ta zhveshur nga historia luftën çlirimtare dhe për ta reduktuar atë në çështje penale individuale. “Kjo gjykatë nuk erdhi nga një nevojë e brendshme për drejtësi, por nga një projekt ndërkombëtar i ndërtuar mbi raporte politike, presione diplomatike dhe interesa gjeopolitike, ku Rusia, Serbia dhe aleatët e saj kanë pasur rol aktiv. Lëvizja Vetëvendosje! e ka kundërshtuar këtë proces që nga fillimi e madje edhe para fillimit, sepse drejtësia nuk mund të jetë selektive, njëetnike dhe e ndërtuar mbi shtrëmbërimin e historisë. Një drejtësi e tillë nuk shëron plagë, por i thellon ato”, është thënë në reagimin e LV-së.

Hamza: Kosova beson në liri për çlirimtarët

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, duke komentuar nisjen e fazës përmbyllëse të një procesi të gjatë dhe të rëndë gjyqësor në Hagë, ka thënë se për më shumë se pesë vjet janë rrëzuar një nga një të gjitha akuzat ndaj krerëve të UÇK-së. Hamza ka thënë se gjatë gjithë këtij procesi çlirimtarët tanë, ekipet e tyre mbrojtëse dhe dëshmitarët kryesorë kanë qëndruar me dinjitet dhe me argumente të fuqishme, duke dëshmuar të vërtetën historike të luftës çlirimtare të popullit të Kosovës. “Tashmë pritët që drejtësia, në mënyrë të paanshme dhe të pandikuar, të marrë vendimin e saj përfundimtar”, ka theksuar Hamza, duke shtuar se ekziston bindje e plotë në pafajësinë e Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi. Ai ka nënvizuar se ky proces nuk përfaqëson vetëm një akt juridik, por edhe një provë të rëndësishme të ndërgjegjes ndërkombëtare ndaj së vërtetës dhe drejtësisë. “Në fund, besimi ynë është i palëkundur, sepse besojmë në të vërtetën historike dhe në luftën e drejtë të popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi” ka përfunduar Hamza. Në mesazhin e tij, ai ka theksuar se Kosova beson dhe ka përsëritur thirrjen: “Liri për çlirimtarët!”.

Reagon bashkëshortja e Rexhep Selimit: Historia nuk rishkruhet. Drejtësi për çlirimtarët!

Shqipe Mehmeti-Selimi, bashkëshortja e Rexhep Selimit, ka reaguar pasi Prokuroria në Hagë ka kërkuar nga 45 vjet burgim për secilin nga katërshja e UÇK-së, përfshirë këtu bashkëshortin e saj. Përmes një postimi në “Facebook”, ajo ka

shkruar se historia nuk rishkruhet, derisa ka kërkuar drejtësi për çlirimtarët. “E shenja UÇK! E shenja është liria për të cilën luftuam e u derdh gjak. Historia jonë nuk rishkruhet. Drejtësi për çlirimtarët!”, ka shkruar ajo.

Djali i Jakup Krasniqit: Kriminalizimi i rezistencës nuk është drejtësi, por rishkrim i rrezikshëm i historisë

Altin Krasniqi, djali i Jakup Krasniqit, ka reaguar pas kërkesës së Prokurorisë në Hagë lidhur me burgimin prej 45 vitesh për secilin nga ish-krerët e UÇK-së. Përmes një postimi në “Facebook”, Krasniqi ka shkruar se prokuroria do ta kishte më të lehtë dhe më të sinqertë të deklaronte hapur se shqiptarët është dashur të rrinin duarkryq, ta praninin vrasjen, përdhunimin, nënçmimin dhe trajtimin çnjerëzor sesa të guxonin të luftonin për mbijetesë dhe dinjitet. “Në këtë narrativë të mbrapshtë dhe thellësisht të padrejtë, problemi nuk janë krimet sistematike të Serbisë, por guximi i një populli për të mos u dorëzuar para shfarosjes. Viktima relativizohet, ndërsa rezistenca kriminalizohet”, ka shkruar Krasniqi.

Megjithatë, sipas tij, historia nuk është shkruar nga ata që u përkulën, por nga ata që refuzuan nënshtrimin. “Një pjesë e vogël e popullit shqiptar zgjodhi rezistencën si akt të fundit mbijetese, jo si zgjedhje politike, por si domosdoshmëri njerëzore. Sot vetë ekzistenca jonë është dëshmia më e fuqishme se ajo luftë ishte e drejtë, e pashmangshme dhe legjitime”, ka shkruar ai.

Çdo përpjekje për ta kriminalizuar këtë rezistencë nuk përfaqëson drejtësi por, siç ka thënë Krasniqi, një akt politik të rrezikshëm që synon rishkrimin e historisë, barazimin e agresorit me viktimen dhe ndëshkimin e së drejtës për liri.

Djali i Hashim Thaçit ripërsërit thirrjen për pjesëmarrje në marshin e 17 shkurtit

Në ditën kur Prokuroria e Hagës ka nisur paraqitjen e deklaratave përfundimtare në rastin gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së, djali i ish-presidentit Hashim Thaçi, Endrit Thaçi, ka ripërsëritur thirrjen për pjesëmarrje në marsh. Ky marsh do të mbahet në Sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë, me fillim nga ora 14:00. “Drejtësi, jo politikë”, organizohet nga platforma “Liria ka emër”.



UÇK-ja SËRISH DO TË TRIUMFOJË!



Bazuar këto tendenca qëllimkëqija të prokurorisë për shtrembërimin e së vërtetës së luftës sonë për liri, që fillin e kanë të Raporti skandaloz i Martyt, tashmë është e qartë se qëllimi i Prokurorisë dhe i qarqeve anti-Kosovë është të rishkruhet historia, duke synuar me çdo kusht të konstatimi i tyre se shteti i Kosovës është storie e dështuar e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe aleatëve të saj, të cilët e ndihmuan UÇK-në në procesin e çlirimit të Kosovës. Prandaj, çdo qytetar i ndërgjegjshëm i Kosovës, çdo politikan dhe udhëheqës institucional e partiak, çdo veprimtar i çështjes kombëtare, duhet ta kuptojnë qartë këtë qëllim të ulët të Prokurorisë së Dhomave të Specializuar të Kosovës dhe të jemi unikë në mbështetjen e konfirmimit të së vërtetës dhe të drejtësisë së luftës sonë çlirimtare, të vërtetës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Duke besuar në drejtësinë e luftës sonë çlirimtare dhe në pafajësinë e drejtuesve të UÇK-së, bashkërisht duhet të kërkojmë të vendoset drejtësi, duke mos lejuar që tendencat politike për barazimin e viktimës me agresorin dhe për rishkrimin e historisë, të ndikojnë në marrjen e vendimit nga Trupi Gjykses!



Shkruan Arianit BYTYÇI

Kur në fund të qershorit të vitit 1998 e shikova për herë të parë xhirimin e Betimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Kleçkë, më pat rënë në sy një luftëtar i ri, i cili me artikullim të qartë dhe me një shqipe të pastër e shqiptonte betimin që po i paraprinte lirisë së Kosovës, që do të vinte vetëm një vjet më pas. Në të njëjtën kohë, në mesin e xhirimeve që babai im Nuhiu me kameramanin e tij të luftës, axhën Abaz kishte realizuar në kuadër të emisionit të parë kushtuar Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, po ashtu dallohej me artikullim të fuqishëm politik dhe ushtarak edhe një luftëtar tjetër, që e

mbushte aq bukur uniformën e UÇK-së. E pyeta babanë me një kureshtje të lartë: “Kush janë këta dy luftëtarë? A janë pjesë e udhëheqjes së lartë të UÇK-së?”. Këtë pyetje e dytë e pata bërë me dëshirën e singertë që në një kohë kur në Prishtinë mbizotëronte një propagandë e ulët anti-UÇK nga qarqe të caktuara politike, ishte me interes që në emër të UÇK-së para opinionit vendor dhe atij ndërkombëtar të paraqiteshin figura, që kishin jo vetëm artikullim të qartë politik dhe ushtarak por edhe paraqitje dinjitoze. Babi mu përgjigj shumë shkurt: “Ai që e interpreton betimin është komandant Çeliku, e luftëtari tjetër është komandant Coli”. Nuk mi dha emrat! Ishte kohë e vështirë dhe për çdo gjë duhej pasur kujdes! Më vonë mora vesh se komandant Çeliku ishte Fatmir Limaj, ndërsa komandant Coli ishte Agim Çelaj. Vetëm një muaj më pas, më 19 korrik 1998 gjeneral Agim Çelaj bie heroikisht gjatë luftimeve në betejën e Rahovecit. Ishte vërtetë humbje

e madhe për UÇK-në, duke marrë parasysh profesionalizmin, përkushtimin dhe moralin që komandant Coli kishte treguar dhe kishte mbjellur tek të gjithë ushtarët e UÇK-së. Më vonë, pas disa muajsh, në dimër të vitit 1998 e pata takuar Fatmir Limajn në Fshat të Ri e Lladroc bashkë me një shok të tij aq të afërt të luftës, i cili ia kishte vënë edhe nofkën e luftës komandant Çeliku, bazuar në përkthimin e emrit të vëllait të Fatmirit, Demirit, i cili asokohe vuante në burgjet serbe, pasi ishte arrestuar bashkë me shumë pjesëtarë të tjerë të UÇK-së në fillim të vitit 1997, pas vrasjes së heronjve Zahir Pajaziti, Edmond Hoxha dhe Hakif Zejnullahu. Shoku i Fatmirit e kishte emrin Rexhep Selimi dhe ishte paraqitur për herë të parë publikisht në varrimin e mësuesit Halit Geci më 28 nëntor 1997 në Llaushë. Ishte bashkëluftëtar i komandantit legjendar Adem Jashari dhe i heroit të kombit Zahir Pajaziti! Pas gjashtë vjetësh e pata takuar

luftëtarin e lirisë, Fatmir Limajn në një rrethanë tjetër të jashtëzakonshme dhe në të njëjtën kohë anakronike për kohën - në burgun e Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, në Sheveningen të Hagës. Nuk mund ta imagjinoja që në të njëjtin burg të takoja Fatmirin, që kishte luftuar për lirinë e atdheut të tij dhe në korridoret e të njëjtin burg të shihja nga afër kasapin e Ballkanit, atë që kishte urdhëruar e shkaktuar gjenocidin në Kosovë, Sllobodan Millosheviqin. Bota asokohe ishte treguar e padrejtë me Kosovën, duke akuzuar luftëtarë të lirisë së Kosovës! Por, Fatmiri u shpall i pafajshëm në të gjitha pikat e aktakuzës, përderisa Millosheviqi vdiq në burgun e Sheveningenit pa marrë dënimin e merituar për gjenocidin dhe të gjitha krimet makabre që Serbia kishte kryer jo vetëm në Kosovë, por edhe në Bosnjë e Kroaci. Dihet botërisht që Fatmir Limaj u përball edhe me dy procese tjera gjyqësore në Kosovë, duke rikonfirmuar pafajësinë e tij dhe të bashkëluftëtarëve të tij. Por, qëllimi për të demonizuar luftën tonë çlirimtare dhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, si organizimi më i suksesshëm politik dhe ushtarak i shekullit njëzetë nuk u ndal me kaq. Pas dhjetëra proceseve gjyqësore të udhëhequra nga drejtësia ndërkombëtare në Kosovë kundër komandantëve të UÇK-së, vite më vonë bazuar në miratimin nga Këshilli i Evropës i raportit skandaloz për kinse trafikim të organeve nga UÇK-ja gjatë luftës, raport i hartuar nga politikani kontrovers Dick Marty, pas presionit ndërkombëtar Kuvendi i Kosovës i themelon Dhomat e Specializuara me seli në Hagë, që në diskursin publik në Kosovë njihet si Gjykata Speciale. Hetimet për akuzat monstruoze për trafikim të organeve rezultuan që në fillim me dështim të plotë, duke mos u dëshmuar ky pretendim i pabazuar i Dick Maryt, e më herët edhe i prokurores Carla Del Ponte. Dhe, në vend që të përmbyllte misionin e vet për të cilin ishte themeluar, pra për të vërtetuar pretendimet për trafikim të organeve, Prokuroria e Dhomave të Specializuara sajoi një aktakuzë të pabazuar me një përmbledhje rastesh të trajtuara nga TPNJ dhe gjykatat e UNIMIK-ut dhe EULEX-it në Kosovë, duke i akuzuar drejtuesit e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi për ndërmarrje të përbashkët kriminale.

Tendencat për ta inkriminuar qëllimin dhe veprimin e Lëvizjes Kombëtare për liri dhe të luftës çlirimtare të UÇK-së

Që nga publikimi i aktakuzës dhe nga fillimi i procesit

gjyqësor, shihet qartë tendenca për demonizimin e luftës çlirimtare të UÇK-së. Duke e trajtuar me tendencë inkriminuese tërë historikun e Lëvizjes Kombëtare të Kosovës për liri, që nga viti 1981 e në vazhdimësi, prokuroria në aktakuzë kulmon me konstatimin se për arritjen e pavarësisë së Kosovës kishte dy opsione: opsioni paqësor i përfaqësuar nga LDK dhe “opsioni i dhunshëm” i përfaqësuar nga UÇK. Skandaloze! A ka argument më të qartë për të gjithë ata që thonë se po gjykohen individët e jo UÇK-ja: kjo prokurori e përdorë formulimin “opsioni i dhunshëm” me qëllime të këqija, duke tentuar që në fillim të inkriminojë edhe vetëm “opsionin” e luftës çlirimtare dhe vetë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës! Edhe në shumë elemente tjera jo vetëm në aktakuzë, por edhe në pyetjet e prokurorëve dhe po ashtu në pyetjet sugjestionuese të Trupit Gjykues, shihet qartë tendenca që duke përdorur madje edhe figurat emblematike të UÇK-së, si komandantin legjendar Adem Jashari dhe heroin Zahir Pajaziti, të inkriminohet e tërë lufta jonë çlirimtare dhe qëllimi i saj fisnik - liria e Kosovës. Në një pjesë të aktakuzës së prokurorisë së Speciales, që është shprehur edhe në gjithë procesin gjyqësor është se UÇK është marrë me njerëzit që nuk iu kanë bashkëngjitur asaj. Kjo tendencë është ripërsëritur edhe në ligjëratën skandaloze të Speciales në një nga shkollat më të dalluara në Republikën e Kosovës, e cila gjatë luftës ishte vënë tërësisht në shërbim të UÇK-së përmes aktiviteve në qendër të Prishtinës - Gjinnazin “Xhevdet Doda”. Kjo akuzë është tërësisht e pavërtetë dhe e paqëndrueshme. Për ta argumentuar këtë konstatim timin, do të prezantoj në mënyrë të përmbledhur një përvojë time gjatë periudhës së luftës çlirimtare. Gjatë natës së vitit të ri 1999, më 31 dhjetor 1998, bashkë me anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Fatmir Limaj e Rexhep Selimi, me luftëtarët Haxhi Shala, Çerkin Dukolli, Naser Hoxha, Shefqet Buçaj, Shaban Dragaj e shumë luftëtarë të tjerë të UÇK-së, si dhe me babain Nuhiun e kameramanin Abaz Zeka, patëm vizituar disa familjet e dëshmorëve Habib e Ali Zogaj, Nuhi Mazrreku dhe disa nga njësitet e UÇK-së në istikame në Tërpezë, Banjë, Lladroc e Javor. Në mesin e vizitave, e mbaj në mend shumë mirë se e patëm vizituar edhe një ushtar të UÇK-së, i cili ishte i plagosur. E kishte emrin Avni Buçaj dhe ishte vetëm 17 vjeçar, ishte i vetmi djalë në familje. Për këtë arsye, komandant Çeliku dhe bashkëluftëtarët e tij disa herë i kishin thënë dhe e kishin detyruar që nga istikamet e luftës të kthehet në shtëpinë dhe familjen e tij. Por, Avniu nuk kishte pranuar, ishte kthyer

përsëri pranë bashkëluftëtarëve në istikame, përderisa një ditë edhe plagoset. Pas disa muajsh, gjatë luftimeve, luftëtari i ri i UÇK-së Avni Buçaj bie dëshmor. Ky rast e dëshmon më së miri karakterin e luftës çlirimtare dhe shpirtin e rinisë shqiptare të Kosovës. Kjo e dëshmon se UÇK ishte ushtri vullnetare, se askush askënd nuk e detyronte e as që kishte mundësi e kapacitet ta detyronte që të inkuadrohej në radhët e UÇK-së. Përkundrazi, radhët e UÇK-së mbusheshin përherë me të rinj e të reja si Avniu e shumë luftëtarë tjerë vullnetarë që kishin ardhur edhe nga mërgimi dhe nga trojet shqiptare në Maqedoni dhe nga Shqipëria, siç është rasti i ardhjes vullnetare të heronjve të kombit, Ismet Jasharit-komandant Kumanovës dhe Tahir Sinanit nga Tropoja. Prandaj, pretendimet e prokurorisë se UÇK është marrë me ata që nuk i janë bashkëngjitur luftës është tërësisht i pavërtetë dhe tendencioz. UÇK ishte ushtri vullnetare, ashtu siç ishte vullnetare edhe lufta jonë për çlirim. Për më tepër, bazuar në këto tendenca qëllimkëqija të prokurorisë për shtrembërimin e së vërtetës së luftës sonë, që fillin e kanë tek Raporti skandaloz i Martyt, tashmë është e qartë se qëllimi i Prokurorisë dhe qarqeve anti-Kosovë është të rishkruhet historia e luftës sonë, duke synuar me çdo kusht tek konstatimi se shteti i Kosovës është storie e dështuar e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe aleatëve të saj, të cilët e ndihmuan UÇK-në në procesin e çlirimit të Kosovës. Prandaj, çdo qytetar i ndërgjegjshëm i Kosovës, çdo politikan dhe udhëheqës institucional e partiak, çdo veprimtar i çështjes kombëtare, duhet ta kuptojnë qartë këtë qëllim të ulët të Prokurorisë së Dhomave të Specializuar të Kosovës dhe të jemi unikë në mbështetjen e konfirmimit të së vërtetës dhe të drejtësisë së luftës sonë çlirimtare, të vërtetës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Tani kur procesi është në fazën e prezantimit të fjalëve përfundimtare të palëve, dhe disa javë apo muaj para vendimit të Trupit Gjykues të gjithë duhet të jemi unikë dhe të mbrojmë bashkërisht themelet e shtetit të Kosovës, që janë ndërtuar me gjakun e dëshmorëve, heronjve dhe martirëve, me sakrificën e luftëtarëve të lirisë dhe me mbijetesën e popullit të Kosovës. Në këtë kohë vendimtare për historinë moderne të Kosovës, duhet lënë anash mlllefet, inatet, qoftë personale apo partiake e politike, sidomos të atyre që gjatë luftës çlirimtare për një apo arsye tjetër objektive apo subjektive nuk kanë arritur të kryejnë obligimin e tyre kombëtar e njerëzor për t’u rreshtuar në UÇK apo të ishin së paku në mbështetje morale të

saj e të luftës çlirimtare. Interesat politike dhe partiake duhet të ndahen nga interesi kombëtar, me qëllim që të gjithë së bashku të çojmë mesazhin e fuqishëm që ky proces gjyqësor të rezultojë me pafajësinë e drejtuesve të UÇK-së, me pafajësinë e UÇK-së!

Të jemi unikë në mbështetje të UÇK-së - të themeleve të shtetit demokratik të Kosovës

Në anën tjetër, me apo pa të drejtë, është normale që ndokush mund të mos pajtohet me veprimet politike e institucionale të pasluftës të ndonjërit apo secilit prej të akuzuarve në Hagë, por kur është në pyetje interesi kombëtar, mbrojtja e të vërtetës historike të luftës çlirimtare të UÇK-së, e cila po gjykohet në Hagë, ato mospajtime politike e partiake nuk duhet t’ia zënë hapësirën rezonimit në interes të së mirës së atdheut. Me gjithë meritat e tyre në procesin e shtetndërtimit e të shpalljes se pavarësisë, ku dy prej tyre (Hashim Thaçi e Jakup Krasniqi) ishin angazhuar politikisht që nga Konferenca e Rambujesë, e cila e përmbylli procesin e çlirimit të Kosovës pas fushatës ajrore të NATO-s mbi caqet ushtarake e policore serbe, e deri te bisedimet e Vjenës, që rezultuan me Pakon e Ahtisaar-it, e cila e bëri të mundur shpalljen e pavarësisë së Kosovës dhe njohjet ndërkombëtare, shumëkush prej nesh me të drejtë asnjëherë nuk është pajtuar me disa nga veprimet dhe vendimmarrjet politike të ndonjërit prej drejtuesve institucional që janë në Hagë, siç janë për shembull mospajtimet me politikën kadrovike në institucionet publike, e cila siç do të shkruante para disa javësh veprimtari i dalluar i LKÇK-së e luftëtari i UÇK-së, Sabit Gashi, ishte e dështuar. Në të njëjtën linjë janë edhe dështimet tjera në përmbylljen e reformave në ekonomi, energjetikë, arsim e shëndetësi, të cilat fatkeqësisht nuk i ka përmbyllur asnjë qeveri e Kosovës deri më tani, e as kjo aktualja. Po ashtu, disa nga luftëtarët e drejtuesit e UÇK-së në Hagë, kur kishin përgjegjësi udhëheqëse institucionale e shtetërore, i avanconin e i mbështesnin shpeshherë të rinjtë e Prishtinës të cilët në vitin 1998 edhe pse ishin të pjekur, nuk e kishin mbështetur me asnjë aktivitet apo veprim Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës e as Lëvizjen Studentore të 1 tetorit 1997, e cila i kishte hapur rrugë daljes së UÇK-së në skenë. Në këtë mënyrë disa nga këta udhëheqës, pas luftës kishin injoruar të rinjtë tjerë por edhe profesorët, të cilët më 1998 dhe 1999 në të njëjtën shkollë ishin angazhuar në mënyrë aktive me të gjithë potencialin e tyre, duke u vendosur në shërbim të plotë të UÇK-së, e duke bërë që kjo

shkollë përmes veprimtarisë së vet në qendër të Prishtinës të ishte zëri i luftëtarëve të lirisë. Disa po prej këtyre drejtuesve që sot janë në Hagë, shpeshherë i tejkalonin e i injoronin miqtë e vërtetë e të sinqertë të kohëve të vështira dhe në të njëjtën kohë për interesa të vogla politike ndërtonin bashkëpunim e miqësi me politikanë e biznesmenë kontrovers që në kohë lufte kishin marrë edhe role tjera jashtë orientimit properëndimor të UÇK-së e të Kosovës. E shumë e shumë gabime tjera, të cilat i kanë pranuar edhe ata vet gjatë paraqitjeve e intervistave nga Haga. Por, sot fokusimi tek këto gabime politike nuk duhet të vijnë në shprehje për arsye se ky proces gjyqësor ka të bëjë me një interes më të madh kombëtar. Sot si kurrë ndonjëherë më parë duhet të jemi unikë në mbështetje të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të historisë sonë më të re, të themeleve të shtetit demokratik të Kosovës, të drejtuesve të luftës sonë për çlirim. Duke besuar në drejtësinë e luftës sonë çlirimtare dhe në pafajësinë e drejtuesve të UÇK-së, bashkërisht duhet të kërkojmë të vendoset drejtësi, duke mos lejuar që tendencat politike për barazimin e viktimës me agresorin dhe për rishkrimin e historisë, të ndikojnë në marrjen e vendimit nga Trupi Gjykues! Në vitin 1998 pas një ofensive të rëndë të forcave policore e ushtarake serbe në të gjitha zonat operative të UÇK-së publikisht përmes një shkrimi të botuar pata shprehur besimin se “Serbia duhet ta ketë të qartë se ofensiva kundër UÇK-së ka dështuar. Serbia ndoshta i ka marrë nën kontroll të përkohshëm disa territore, por UÇK-në nuk e ka shkatërruar dhe nuk mund ta shkatërrojë kurrë. UÇK-ja është vetë populli. Lufta çlirimtare e trimave të lirisë po hyn në një fazë të rëndësishme dhe duhet të kuptojmë një herë e përgjithmonë se vetëm vazhdimi i saj dhe një politikë më aktive mund të na çlirojë nga Serbia”. Edhe sot, 28 vite pas, me të njëjtin besim në luftën çlirimtare të UÇK-së, e shpreh bindjen e palëkundur se ofensiva e egër e Serbisë dhe e qarqeve anti-Kosovë, e shprehur në narrativën e aktakuzës së Prokurorisë së Speciales, e cila shërbehet edhe me fabrikimet e prokurorisë serbe (gjë që e ka pranuar edhe vetë kjo prokurori) do të dështojë, siç ka dështuar edhe tendenca skandaloze e akuzave monstruoze për trafikim të organeve. Ushtria Çlirimtare e Kosovës do të qëndrojë gjithmonë lartë, në vlerat më sublime të kombit tonë! Historia e luftës çlirimtare të Kosovës nuk mund të rishkruhet! Drejtësia dhe e vërteta duhet të fitojnë! Prandaj, UÇK-ja sërish do të triumfojë!

Policia sekuestron rreth 7 kg marijuanë dhe arreston një person të dyshuar

PRISHTINË, 9 SHKURT - Policia e Kosovës, më saktë Drejtoria për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve, ka realizuar një plan taktik të paraprirë nga hetimet paraprake, ku në pikën kufitare në Merdar është ndaluar një veturë e dyshuar me targa të huaja, e drejtuar nga i dyshuari mashkull

kosovar. Gjatë kontrollimit të veturës janë gjetur dhe janë konfiskuar rreth 7 kg substancë e dyshuar narkotike e llojit marijuanë, në vlerë tregu rreth 35 000 (tridhjetë e pesë mijë). Lidhur me rastin, në koordinim me Prokurorinë

Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë është realizuar kontrolli i shtëpisë së të dyshuarit në Prizren, ku në cilësinë e provave materiale janë gjetur dhe janë sekuestruar dëshmitë si në vijim: 7 kg substancë e dyshuar narkotike e llojit marijuanë (e ndarë në 24

paketime), 4 vetura, 1 telefon, 9 paketime me qese plastike, dy rollne plastike, 2 aparate për vakum, 2 peshore digjitale si dhe prova të tjera materiale që ndërlidhen me rastin. Lidhur me rastin personi i dyshuar është arrestuar dhe me vendim të prokurorit është dërguar në ndalim për 48 orë.



OSMANI: RRUGA E KOSOVËS DREJT NATO-s DHE BE-së ËSHTË E PANDALSHME, MARRËDHËNIET ME SHBA-NË PO THELLOHEN

PRISHTINË, 9 SHKURT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në një intervistë për median britanike “Monocle”, ka folur për përparimin e Kosovës në rrugën e integritit euroatlantik dhe për thellimin e marrëdhënieve me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Duke folur për angazhimin e Kosovës në politikën ndërkombëtare dhe integrimin në strukturat euroatlantike, presidentja Osmani tha se nuk kemi dilema për rrugën tonë euroatlantike. Rrugë e Kosovës drejt NATO-s dhe Bashkimit Evropian është e pandalshme. Identiteti ynë euroatlantik është i patjetërsueshëm dhe nuk do të lëkundet kurrë”, u shpreh Osmani. Ajo theksoi rëndësinë e mbështetjes amerikane historike dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm. “Marrëdhënia që kemi me ShBA-në ka qenë gjithmonë ekzistenciale. ShBA-ja

udhëhoqi botën për të na shpëtuar dhe na dha mundësinë të jetojmë në liri dhe demokraci. Kosova është bërë një nga historitë më të mëdha të suksesit të politikës së jashtme amerikane”, tha ajo. Presidentja përmendi dy fusha kryesore të bashkëpunimit të zgjeruar me ShBA-në, mbrojtjen dhe ekonominë. “Në aspektin e mbrojtjes është shumë e rëndësishme që të kemi kapacitete të mjaftueshme për sigurinë tonë, sidomos duke pasur parasysh situatën e paqëndrueshme në rajon. Në ekonomi kemi potencial të madh për investime amerikane. Kur investoni në Kosovë, po investoni në qindra miliona qytetarë evropianë, me një sistem ligjor dhe financiar të shkëlqyer dhe me një vend pro-amerikan”, tha Osmani. Duke folur për sfidat e integritit në BE, presidentja Osmani tha se pavarësisht që Kosova ende nuk e



ka marrë statutin e kandidatit për BE, rruga jonë drejt vlerave euroatlantike nuk do të ndryshojë. “Ne jemi 100 % të përputhur me BE-në dhe NATO-në në çdo vendim të politikës së jashtme dhe sigurisë. Megjithatë, ende nuk kemi status kandidatit për Bashkimin Evropian për shkak të disa konsideratave politike brenda disa vendeve të

BE-së. Por durimi ynë nuk do të shkurtëzohet - rruga jonë drejt vlerave euroatlantike nuk do të ndryshojë”, tha Osmani. Presidentja Osmani vlerësoi mbështetjen e vazhdueshme të Emirateve të Bashkuara Arabe si një partner i rëndësishëm ndërkombëtar. “Që nga viti 1999, kur përjetuam luftën gjenocidale, Emiratet e Bashkuara Arabe na

mbështeti ta rindërtojmë vendin nga hiri. Tani na mbështesin në sektorin e shëndetësisë dhe shumë sektorë të tjerë. Kjo mbështetje është jetike për forcimin e pozicionit ndërkombëtar të Kosovës”, tha Osmani. Kujtojmë se presidentja Osmani javën që shkoi ishte pjesëmarrëse në Samitin Botëror të Qeverisjes në Emiratet e Bashkuara Arabe.

KOMANDANTI I FSK-së DEKORON EKIPIN E KËRKIM-SHPËTIMIT NË SHQIPËRI



PRISHTINË, 9 SHKURT - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneraljejtënant Bashkim Jashari, priti në takim pjesëtarët e njësisë së Kërkim Shpëtimit të Regjimentit të Mbrojtjes Civile të Gardës Kombëtare të FSK-së të cilët kanë qenë të angazhuar në operacionin humanitar të kërkim shpëtimit në Republikën e Shqipërisë. Fillimisht, gjeneral Jashari falënderoi pjesëtarët që kanë qenë të angazhuar në operacionin humanitar të kërkim-shpëtimit në Klos të Republikës së Shqipërisë. Me këtë rast GLT Jashari i përgëzoi

për punën, profesionalizmin dhe angazhimin pjesëtarët në fjalë, të cilët e përfunduan me sukses këtë operacion në kushte të ftohta dimërore. Në fund të takimit, GLT Jashari dekoroi pjesëtarët e angazhuar në këtë operacion humanitar me medaljen “Shërbim Vetëmohues” dhe dekoroi me “mirënjohje” njësinë në fjalë. Forca e Sigurisë së Kosovës ka theksuar se mbetet e përkushtuar në forcimin e bashkëpunimit rajonal duke dëshmuar ngritje të kapaciteteve dhe profesionalizëm si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

Qeveria publikon programin e manifestimeve shtetërore për 18-vjetorin e Pavarësisë

PRISHTINË, 9 SHKURT - Qeveria e Kosovës ka publikuar të hënën programin e manifestimeve shtetërore për shënimin e 18-vjetorit të Pavarësisë. Më 17 shkurt në orën 07:00 do të

bëhet ngritja e flamurit të Republikës së Kosovës, në orën 9:00 do të bëhen homazhe në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz, ndërsa në orën 10:30

do të mbahet seanca solemne e Kuvendit të Kosovës. Në orën 11:30 do të parakalojnë trupat e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Policisë së Kosovës, ndërkaq

në orën 17:30 do të bëhet pritja shtetërore nga presidentja Vjosa Osmani, kryetari i Kuvendit, Dimal Basha dhe kryeministri Albin Kurti.



Rritje e numrit të vizitorëve në hotele në dhjetor të 2025-s krahasuar me vitin paraprak

PRISHTINË, 9 SHKURT - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën e hotelesterisë për muajin dhjetor 2025.

Në dhjetor 2025 numri i vizitorëve në hotele ishte 68 293, prej tyre vizitorë vendorë ishin 27 776 dhe

vizitorë të jashtëm ishin 40 517.

Krahasuar me muajin dhjetor të vitit 2024 (sa ishin 64 380 vizitorë) pati rritje të numrit të përgjithshëm të vizitorëve në hotele për 6,1 %.

Numri i net-qëndrimeve

ishte 132 148, prej tyre 71 624 (54,2 %) nga vizitorët e jashtëm dhe 60 524 (ose 45,8 %) vendorët e brendshëm.

Numrin më të madh të vizitorëve të brendshëm në hotele e ka rajoni i Pejës me 9 655 vizitorë dhe me 26 550 net-qëndrime.

Sa iu përket vizitorëve të huaj, krahasuar me periudhën paraprake (dhjetor 2024) pati një rritje të vizitorëve për 2,5 %.

Në total, 40 517 vizitorë të huaj, nga të cilët numri më i madh ishte nga: Shqipëria, Gjermania, Zvicra, Turqia etj.



RRITET INDEKSI I PËRGJITHSHËM I INPUTEVE NË BUJQËSI

PRISHTINË, 9 SHKURT - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Inputeve në Bujqësi për tremujorin e katërt (TM4) 2025. Ky publikim është i bazuar në çmimet e inputeve bujqësore të grumbulluara në Kosovë. Grumbullimi i çmimeve është kryer në barnatoret bujqësore, farmacitë veterinare, në kompani, tregje dhe vende të tjera, ku çmimet e inputeve bujqësore janë në dispozicion.



Në TM4 2025, Indeksi i Input 1 ka rritje për 4,3 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024, kurse Indeksi i Input 2 ka rritje për 3,7 % krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024.

Indeksi i inputit të përgjithshëm (Input 1 + Input 2) ka rritje për 4 %, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024.

Produktet që e përbëjnë bazën për Indeksin e çmimeve të inputeve janë të ndara në dy grupe kryesore: Mallrat dhe

shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi (Input 1) dhe Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet në bujqësi (Input 2).

Brenda grupit të Mallrave dhe shërbimeve aktualisht të konsumuara në bujqësi, çmimet grumbullohen sipas grupeve në vijim: farëra dhe material mbëltues, energji; vajra, plehra dhe përmirësues të tokës, produkte për mbrojtjen e bimëve dhe pesticide, shpenzime për

veterinari, lëndë për ushqimin e kafshëve, mirëmbajtja e materialeve, mirëmbajtja e ndërtesave, si dhe mallra dhe shërbime të tjera. Sa iu përket mallrave dhe shërbimeve që kontribuojnë në investimet bujqësore, çmimet grumbullohen për materiale (makineri dhe pajisje të tjera), ndërtesat dhe të tjera (ndërtesat jorezidente të fermës, punët e tjera përveç përmirësimit të tokës).

AKB-ja: MBI 450 MILIONË EURO PËR RAJONIN, ZERO EURO PËR KOSOVËN

PRISHTINË, 9 SHKURT - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) shpreh shqetësimin dhe indinjatën e thellë për faktin se 455 milionë euro nga Plani i Rritjes i Bashkimit Evropian janë përfutur nga Serbia, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, ndërsa Kosova nuk ka përfutur asnjë euro të vetme. “Kjo nuk ka ndodhur për shkak të Bashkimit Evropian. Ka

ndodhur për shkak të papërgjegjësisë dhe bllokadës politike në Kosovë. Derisa vendet e rajonit po ecin përpara me investime dhe zhvillim ekonomik, Kosova po mbetet peng i krizës politike dhe moskonstituimit të institucioneve, duke rrezikuar humbjen e fondeve jetike për bizneset, vendet e punës dhe mirëqenien e qytetarëve”, ka

vlerësuar kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini.

Ai ka thënë se Kosova ka të drejtë të përfitojë rreth 880 milionë euro nga Plani i Rritjes, më së shumti për kokë banori në Ballkanin Perëndimor, por për shkak të dështimit politik, po rrezikon t'i humbasë këto mjete të jashtëzakonshme. “BE-ja ishte gati, fondet ishin aty, por

Kosova dështoi për shkak të mungesës së përgjegjësisë politike. Ekonomia e vendit nuk mund dhe nuk duhet të mbahet peng e krizave politike. Humbja e këtyre fondeve është dështim serioz që po e paguajnë bizneset dhe qytetarët. Aleanca Kosovare e Bizneseve kërkon veprim të menjëhershëm, konstituim të institucioneve dhe miratim pa vonesë të Planit të Rritjes dhe



buxhetit të vendit. Bizneset po humbin. Qytetarët po paguajnë. Politika duhet të veprojë tani”, ka thënë Shahini.

KEK-u THOTË SE KA PRODHUAR MBI 110 MIJË MWH MË SHUMË ENERGJI ELEKTRIKE NË DY MUAJ

PRISHTINË, 9 SHKURT - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK Sh.A.) ka shënuar rritje të ndjeshme të prodhimit të energjisë elektrike gjatë muajve dhjetor 2025 dhe janar 2026 si rezultat i operimit stabil dhe menaxhimit të koordinuar të kapaciteteve prodhuese. Sipas njoftimit të KEK-ut, kjo rritje është arritur falë operimit të qëndrueshëm mbi standardin



normal, në veçanti përmes funksionimit të njëkohshëm të tri njësive të Termocentralit Kosova A. “Korporata Energjetike e Kosovës - KEK Sh.A. ka realizuar rritje të ndjeshme të prodhimit të energjisë elektrike gjatë muajve dhjetor 2025 dhe janar 2026 si rezultat i operimit stabil dhe menaxhimit të koordinuar të kapaciteteve prodhuese”, thuhet në

njoftimin e KEK-ut.

Gjatë muajit dhjetor 2025 prodhimi i energjisë elektrike ka arritur në 127 për qind të nivelit të regjistruar në të njëjtin muaj të vitit paraprak, që përfaqëson një rritje prej 27-përqindësh, apo 46 539 MWh më shumë energji elektrike.

Ndërkaq, në muajin janar 2026 KEK-u bën me dije se prodhimi ka shënuar 132.9 për

qind të nivelit të janarit të vitit paraprak, që përkthehet në një rritje prej 32.9-përqindësh, respektivisht 63 003 MWh më shumë energji elektrike. “Në total, gjatë këtyre dy muajve, KEK Sh.A. ka realizuar një rritje të konsiderueshme të prodhimit prej rreth 110 mijë MWh më shumë energji elektrike krahasuar me periudhën përkatëse të viteve paraprake”, thuhet në njoftim.

IKShPK: Uji i pijshëm nga liqeni i Badocit tani i sigurt për konsum

PRISHTINË, 9 SHKURT - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se nga monitorimet e fundit të cilësisë së ujit të pijshëm në zonën e furnizimit PR03 nga Ujësjellësi i Badocit është vërejtur ulje e dukshme e

vlerave të turbullirës. “Analizat laboratorike të realizuara gjatë tri ditëve të fundit në laboratorin e IKShPK-së tregojnë se vlerat e turbullirës dhe të gjithë parametrave të tjerë (bakteriologjikë dhe fiziko-kimikë) janë brenda

kritereve të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ (UA) nr. 10/2021 - ‘Cilësia e ujit të destinuar për konsum nga njeriu’. Bazuar në këto rezultate laboratorike dhe në përputhje me UA 10/2021, uji në zonën e furnizimit PR03 nga

Liqeni i badocit është i sigurt për pije”, ka njoftuar IKShPK-ja.

IKShPK-ja ka theksuar se në bashkëpunim me institucionet përkatëse do të vazhdojë monitorimin e rregullt dhe të vazhdueshëm të cilësisë së ujit,



duke garantuar transparencë dhe informim të saktë për qytetarët.

TANI E DIMË SE ÇFARË PËRFITUAN TË GJITHË ATA NJËRËZ NGA EPSTEINI



Nga Molly JONG-FAST


Jeffrey Epstein, siç u bë e qartë sërish me publikimin e fundit të dosjeve nga Departamenti i Drejtësisë, do të mbetet në histori si ndoshta “zamka” sociale më i suksesshëm i këtij shekulli. Ai njihte pothuajse këdo; duke përmendur emra të rëndësishëm, duke tregtuar favore, duke trafikuar për seks dhe ndoshta duke shantazhuar, u ngjiti drejt majave më të larta. Duket se vetëm Vladimir Putini ishte i paarritshëm prej sharmit të tij mefistofelian. Shumë nga njerëzit që rezultuan se e njihnin mirë, më parë kishin pretenduar se e njihnin fare pak, dhe të gjithë tani po pohojnë se sigurisht nuk e njihnin mjaftueshëm sa për të qenë dëshmitarë të pedofilisë. Tani ata janë të turpëruar nga lidhja e tyre, dhe shpeshherë, pa punë. Shumë njerëz i qëndruan pranë edhe pasi shkoi në burg në vitin 2008 në Florida për krime seksuale, dhe në disa raste edhe pasi përfundoi sërish në burg në vitin 2019, me akuza për trafik seksual. Atëherë, fati i viktimave shpesh dukej si diçka dytësore. Kjo ka shumë të ngjarë sepse çfarëdo që ata kishin marrë prej tij në të kaluarën, qasje te njerëz që i ndihmonin në karrierë, qasje te vajza të reja dhe një furnizim i pafund me dhurata falas, mund të ishte ende në ofertë. Kjo është natyra e dosjeve Epstein: Është regjistri i asaj që një klasë globale njerëzish shumë të privilegjuar, të realizuar dhe me shumë vetëvlerësim, duan që t’u

dhurohet. Ndonjëherë ishte një çantë Prada. Herë të tjera ishte një fluturim me avionin e zotit Epstein, ose një fundjavë në ishullin e tij. Ndonjëherë ishte një donacion për një bamirësi ose shkollë. Ose një punë për fëmijën e tyre në një film të Woody Allen, apo një rrugë e shkurtër për fëmijën e vetë zotit Allen për t’u futur në Bard. Ndonjëherë ishte një “bionde e gjatë suedeze”. Herë të tjera ishte një grua e re që mund të ishte “pak e trembur nga diferenca në moshë”. Duke shkruar mbi një grup të mëparshëm email-esh në The Times, Anand Giridharadas pyeti: “Si arriti zoti Epstein të afronte aq shumë të panjohur? Email-et zbulojnë një ekonomi shkëmbimi të informacioneve jopublike që ishte një tërheqje e madhe. Kjo nuk është një botë ku ti sjell një shishe verë për darkë.” Informacioni i brendshëm nuk ishte gjëja e vetme që Epstein kishte në dorë. Fotografia e ofruar nga dosjet e fundit tregon se si Epstein fitonte favore dhe miqësi duke vepruar si një lloj “super-shërbyesi”. Ndonjëherë kjo nënkuptonte dërgimin e helikopterit për të marrë të ftuarit, siç u ofrua të bënte për Elon Musk në një email të vitit 2012, duke shkruar: “Sa veta do të jeni për helikopterin drejt ishullit?” Në një rast tjetër, Musk pyeti shërbyesin e tij Epstein: “A ke ndonjë festë të planifikuar?” Epstein ofroi udhëtime me avionë privatë, praktika pune (internshipe), Apple Watch, çanta Hermès, xhupa me zinxhir ekstra të mëdhenj (këta i shkuan Steve

Bannon), pothuajse 10,000 dollarë vlerë mbathje dhe bluza (Woody Allen) dhe një triko kashmiri XXL (Noam Chomsky). Dhe pastaj është ylli i Substack-ut, Michael Wolff, i cili është kudo në dosjet Epstein: “Këpucët janë shumë të bukura. Faleminderit.” Ka mënyra të shumta për t’u dukur budalla dhe i pështirë në dosjet Epstein, më e keqja prej të cilave janë padyshim email-et si ai që Peter Attia i shkroi Epsteinin në vitin 2016, tetë vjet pasi Epstein ishte regjistruar si kriminel seksual: “P*rdha është, me të vërtetë, me pak karbohidrate. Ende po pres rezultatet për përmbajtjen e glutenit, gjithsesi.” Të gjithë e kanë parë me siguri deri tani foton e dikurshme të Princit Andrew me krahun rreth 17-vjeçares Virginia Giuffrë. Ekziston edhe një foto e Bill Clintonit në një vaskë me ujë të ngrohtë. Ka email-e të tjerë, në dukje më të parëndësishme, që janë po aq diskretitues, sepse tregojnë një botë ku është në rregull të sjellësh fëmijët e tu në ishullin e një kriminelit seksual. Në vitin 2012, gruaja e Sekretarit të Tregtisë Howard Lutnick i shkroi asistentes së Epstein, Lesley Groff: “Do të vijmë nga Caneel Bay në mëngjes,” duke sjellë “dy familje, secila me katër fëmijë të moshave nga 7-16 vjeç! Gjashtë djem dhe dy vajza. Shpresoj të jetë ok.” Më vonë, Lutnick gënjeu për lidhjen e tij me Epsteinin, duke thënë se ishte aq i “pështirosur” nga Epsteini në 2005-ën, sa që nuk kishte më kontakte. Në vitin 2017, Epstein dhuroi 50,000 dollarë në nder të Lutnickut për një

organizatë të panjohur. Shumë prej email-eve tregojnë një botë që përfshin një formë të rritjes së statusit përmes ndërmjetësimit. Epstein përdori miqtë e tij të Hollivudit (Allen dhe Brett Ratner, regjisorin e ardhshëm të dokumentarit “Melania”) për të joshur miqtë e tij të pasur e të zgjuar, por jo magjepsës. Një fluturim falas me avion për një person me status të lartë (ndoshta edhe një anëtar oborri mbretëror), i cili përndryshe nuk ka qasje në një avion privat, bën punë të madhe. Në vitin 2016, Brad Karp, kryetari i Paul Weiss, firma ligjore më prestigjioze në Nju Jork dhe një nga të parat që arriti marrëveshje me administratën Trump, i shkroi Epsteinin: “A mund të diskutoj një çështje personale me ty në lidhje me djalin tim David?” Ai vazhdoi: “Ai do të dëshironte shumë të punonte, në çfarëdo cilësie, me Woody-n në projektin e tij të ardhshëm filmik, nëse kjo është e mundur. Sigurisht, ai nuk ka nevojë të paguhet dhe është një djalë vërtet i mirë dhe i talentuar.” Një prind që i kërkon një miku një punë për fëmijën e tij vështirë se është e paligjshme. Por është interesante që firma ligjore e Karp ishte një nga të parat që bëri një marrëveshje me administratën e një personi tjetër, që shfaqet mijëra herë në dosjet Epstein, Donald Trumpit. Dhe çfarë ka të bëjë zoti Trump me këtë? Ai kishte premtuar të pastronte Amerikën pikërisht nga ai lloj i elitës globale vetëshërbyese, në mes të së cilës ishte Epstein. “Askush nuk e njeh sistemin më mirë se unë, prandaj

unë i vetëm mund ta rregulloj atë,” tha Trump në fjalimin e tij të vitit 2016 duke pranuar kandidimin republikan. Ishte një mesazh që pati jehonë, dhe kur e shikon fjalimin përsëri siç bëra unë para disa ditësh, entuziazmi i turmës është mbresëlënës. Më në fund, po i tregonte popullit amerikan sekretin e tmerrshëm se pavarësisht sa fort punonte dikush, pavarësisht sa i zgjuar ishte, nuk kishte asnjë mënyrë për të ecur përpara në Amerikën e vitit 2016. Nuk ishte faji i tyre. Ishte faji i elitave. Rreth kësaj kohe, ne pamë rritjen e QAnon, një teori konspirative që pretendonte se një rrjet trafikimi seksual po drejtohej nga elitat, nga bodrumi joekzistent i një dyqani picash. QAnon na dukej teori e çmendur neve të tjerëve në atë kohë, dhe është ende e çmendur, por dosjet Epstein tregojnë se ajo dosje kishte paralele në realitet. Ka shumë sekrete të tmerrshme të varrosura në dosjet Epstein, të cilat përziejnë të rëndomtën dhe tmerrin, etjen për vëmendje dhe krimin, dhe ndoshta kjo është pjesa më shqetësuese e gjithë kësaj. Të mbështjella rastësisht së bashku me një fjongo janë burrat e “anuluar”, trafikimi seksual dhe këshillat mediatike nga Michael Wolff. Të qenit një kriminel seksual i dënuar nuk e bëri Epsteinin një personazh të dëbuar, jo kur ai dukej se kishte ende diçka për të ofruar. Amoraliteti i tij transaksional në fakt dukej se ia shtonte tërheqjen njerëzve që ishin të bindur se rregullat nuk vlenin për ta. / The New York Times – Bota.al



Distria Krasniqi rrëmben medaljen e artë në Grand Slamin e Parisit

PARIS, 9 SHKURT - Distria Krasniqi ka triumfuar me medaljen e artë në Grand Slamin e Parisit në kategorinë deri në 52 kilogramë. Pas një rrugëtimi të gjatë deri në

finale, Distria ka mposhtur spanjollen Ariane Toro Soler me Ippon vetëm në 10 sekonda, duke siguruar kështu medaljen më të rëndësishme. Xhudistja e Kosovës po konsolidon

titullin e saj si “mbretëresha e Grand Slamit të Parisit”, pasi tashmë ka fituar nëntë medalje në këtë turne. Federata Evropiane e Xhudos e ka shpallur videon nga finalja e saj

duke e cilësuar si mbretëreshë. “Mbretëresha e Parisit: 9 medalje deri më tani, katër prej tyre të arta”, ka treguar Federata Evropiane e Xhudos së Kosovës.



NIS STINORI PRANVEROR NË SUPERLIGËN E KOSOVËS NË FUTBOLL, FITOJNË FAVORITËT

PRISHTINË, 9 SHKURT - Stinori pranveror në Albi Mall Superligën e Kosovës ka nisur në fundjavën që shkoi. Kampionia në fuqi, Drita, ka arkëtuar tri pikë të rëndësishme në udhëtim, duke e mposhtur Ferizajn me rezultat 1:0. Golin e vetëm të ndeshjes e ka realizuar Kristal Abazaj në minutën e 50, duke shënuar golin e pestë në këtë edicion. Me këtë fitore, Drita është ngjitur në vendin e tretë me 32 pikë, ndërsa Ferizaj mbetet në pozitën e nëntë me 19 pikë. Fitore të rëndësishme ka shënuar edhe Prishtina, e cila ka triumfuar në udhëtim ndaj Dukagjinit, me rezultat 1:0, në stadiumin “18 Qershori” në Klinë. Goli i fitores ka ardhur në minutën e 14-t me golin e Gjelbrim Taipit, gjuajtja e të cilit ka qëlluar shtyllën e më pas nga shpina e portierit Egzon Fekaj ka përfunduar në

portë. Me këtë fitore Prishtina mban vendin e dytë me 33 pikë, ndërsa Dukagjini zbrit në pozitën e pestë me 29 pikë. Ndërsa ndeshja në mes të Drenicës dhe Llapit është mbyllur pa fitues, me rezultat 1:1. Takimi është zhvilluar në stadiumin “Liman Gegaj” në Malishevë për shkak të gjendjes së rënduar të terrenit në Skenderaj pas vërshimeve të disa javëve më parë. Drenica ka kaluar e para në epërsi me golin e Ronaldo Chaconit në minutën e 17, por ka mbetur me një lojtar më pak nga minuta e 65-të, pas përjashtimit të Igbal Jasharit. E këtë epërsi numerike në fushë Llapi e ka kapitalizuar në minutën e 82-të përmes Arbnor Ramadanit, duke barazuar shifrat dhe duke siguruar një pikë. Llapi renditet i shtati me 22 pikë, ndërsa Drenica e teta me 21 pikë.

Në kuadër të xhiros së 19 Ballkani ka fituar si mysafir ndaj Gjilanit (2:1). Me këtë fitore Ballkani renditet në vendin e parë në tabelë me 36 pikë. Fitore ka shënuar edhe Malisheva, e cila ka mposhtur Prishtinën e Re (1:0).

RENDITJA TABELARE PAS XHIROS SË 19-TË

Ballkani	36
Prishtina	33
Drita	32
Malisheva	30
Dukagjini	29
Gjilani	26
Llapi	22
Drenica	21
Ferizaj	19
Prishtina e Re	15



ALMIR KRYEZIU, ‘YLLI I JAVËS’ NË SUPERLIGË



PRISHTINË, 9 SHKURT - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK), në bashkëpunim me sponsorin zyrtar të Superligës, Albi Mall, vazhdon ta japë çmimin tradicional “Ylli i Javës”, i cili i dedikohet futbollistit më të dalluar të javës në Superligën e futbollit të Kosovës. Për javën e 19 ky çmim i është dhënë për herë të dytë në këtë edicion futbollistit të FC Ballkanit, Almir Kryeziu, i cili ka pasur paraqitje individuale shumë të mirë për skuadrën gjatë 88 minutave sa ishte në fushë, duke shënuar një gol dhe duke

asistuar në golin e dytë, për të siguruar kështu fitoren për skuadrën kundër Gjilanit, me rezultat 1:2. Vlerësimi është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit. Pasi ka marrë çmim, Kryeziu është shprehur i lumtur që është vlerësuar lojtari më i mirë i javës. “Kemi pasur një fazë përgatitore shumë të mirë dhe kemi pasur kohë të mjaftueshme për ta analizuar Gjilanin. Ekipi ka qenë shumë i mirë edhe në sezonin e kaluar, megjithatë këto transferime kanë rritur konkurrencën, por

edhe kualitetin në ekip. Synimi i FC Ballkanit tashmë dihet se është dalja kampion dhe jemi në rrugën e mirë për ta arritur këtë qëllim, por jemi edhe në garë për Kupën e Kosovës, andaj do të luftojmë në të dyja garat. Falënderoj Federatën e Futbollit të Kosovës për vlerësimin si më i miri i xhiros si dhe bashkëlojtarët dhe stafin e trajnerëve, sepse pa ta kjo performancë nuk do të ishte e mundur”, ka thënë ai për faqen zyrtare të FFK-së.

Sunderlandi edhe katër ndeshje pa Xhakën

SUNDERLANDI, 9 SHKURT - Mungesa e Granit Xhakës po del të jetë më e madhe sesa është menduar te skuadra e Sunderlandit. Kapiteni Xhaka i ka munguar Sunderlandit në tri ndeshjet e fundit në Premierë

Ligë për shkak të lëndimit të nyjës, ndërsa pritet t'i mungojë edhe në katër ndeshje. Ai ka munguar në humbjet nga West Ham Unitedi dhe Arsenali si dhe në fitoren kundër skuadrës së Burnleyt.

Thuhet se Xhaka nuk do të luajë as të mërkurën mbrëma kundër Liverpoolit, por do të mungojë edhe ndaj Oxford Unitedit në vikend, si dhe Fulhamit e Bournemouthit. Te Sunderlandi po shpresojnë

që Xhaka të jetë gati deri në fund të muajit, pasi është një prej lojtarëve më të rëndësishëm të ekipit. Në këtë sezon Xhaka ka shënuar 1 gol dhe ka bërë 5 asistime në 22 ndeshje të luajtura në kampionatin anglez.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë





www.facebook.com/gjejpuneshpejte


RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Abropa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

NJOFTIM

Njoftojmë se kompania "DUKAGJIN SOLAR SHPK" nga Prishtina, me numër unik identifikues 811507849 ka marrë vendim për mbyllje të biznesit.

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët afarist që kanë raporte Debitore-Kreditore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin prej 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

NOTIFICATION

We inform all customers that the company "DUKAGJIN SOLAR SHPK" with address in Prishtina, has decided to close the business with unique identification number 811507849, and has appointed the liquidator for the development of the liquidation procedure. All clients who have Credit-Debt reports in this company are notified to appear within 30 days from the date of publication in the newspaper.

OBAVEŠTENJE

Obaveštavamo svu klijentelu da je kompanija "DUKAGJIN SOLAR SHPK", sa adresom Prishtina, odlučila da pestaje radni aktivnost sa jedinstvenim identifikacionim brojem 811507849, i imenovao likvidatora za razvoj postupka likvidacije. Svi klijenti koji imaju kreditno-debitne izveštaje u ovoj kompaniji su obavešteni da se pojave u roku od 30 dana od dana objavljivanja u novinama.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Princesha-Bani-Com" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810962416.
- Osman Gjigja shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfm u "Shaban Golaj" Lipovec Gjakovë.
- Arben Rama shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Arifqe Gutaj shpall të pavlefshme dëftesën e sh.m.u të gjmnazit "Gjon Buzuku" Prizren.
- Rifat Plava shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Ali M Hasi" Cërmjan Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjmnazit "Hajdar Duishi" Gjakovë.
- Bekim Brahimaj shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Kreshnik Kusari B.I. shpall të pavlefshme nr. Certifikatën e biznesit 810110289 të lëshuar nga MTI e Kosovës.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Kristjan Luli shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- D.P.Z. "Ylli" shpall të pavlefshme numrin e biznesit 70683016 të lëshuar nga MTI e Kosovës.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Andi Reznici shpall të pavlefshme diplomën e shkollës se mesme ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

